



VENDIM
Nr. 3, datë 27.03.2020

PËR SHTYRJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE HUMANE "ISMAIL QEMALI" VLORE.

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në zbatim të nenit 7 pika 6/d, nenit 18, pika 3 të Vendimit të Senatit Akademik Nr.59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë; Vendimit Nr.1, datë 18. 03. 2020 "Për Shpalljen e fituesit të Kryetarit të Komisionit Zgjedhor pranë Fakultetit të Shkencave Humane (KZFSHH); si edhe Urdhrit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 99, datë 26.03.2020 "Për disa ndryshime në Urdhrit Nr. 8, datë 14.01.2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", Komisioni Zgjedhor i Fakultetit:

VENDOSI:

1. Të miratojë shtyrjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përherëshme në Njesisë Kryesore në Fakultetin e Shkencave Humane në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve nga data 24.04.2020 deri në datën 28.04.2020, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Shkencave Humane për të depozituar dokumentacionin për kandidim. Pas regjistrimit, kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shkencave Humane.
4. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe në faqen zyrtare www.univlori.edu.al
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit:
Erjona Dervishalaj

Elonora Hodaj (Anëtare)
Adelajda Beqaj (Anëtare/studente)
Blerina Xhelaj (Sekretare)